



RREGULLAT THEMELORE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETIT "5 VJET MARIGONA HILL"

Me rastin e pesë vjetorit të Marigona Hill dhe lansimit të fazës së tretë "The Gallery", Marigona Hill nga data 3 qershor deri me 31 gusht 2024 do të shpërblejë secilin blerës me njërin nga dhuratat e këtij aktiviteti, si dhe njërin nga blerësit do ta shpërblejë me veturën Toyota bZ4X 4X4. Këto rregulla themelore për ndarjen e shpërblimeve gjatë periudhës së fushatës janë hartuar dhe miratuar për të siguruar transparencë të plotë për të gjithë pjesëmarrësit dhe publikun.

ORGANIZATORI DHE PJESËMARRËSIT ME TË DREJTË SHPËRBLIMI

Organizator i këtij aktiviteti është Marigona Hill sh.p.k., me numër biznesi: 810188591 dhe adresë: Hajvali, Rr. Dëshmorët e Gollakut, Marigona Hill.

Emri zyrtar i fushatës është "5 vjet Marigona Hill".

Të drejtën e pjesëmarrjes në ndarjen e shpërblimeve të listuara më poshtë e kanë të gjithë klientët e rinj që blejnë pronë të paluajtshme nga Marigona Hill sh.p.k. nga data 03.06.2024 (duke filluar nga ora 00:01) deri më 31.08.2024 (deri në orën 23:59) dhe të cilët i përmbushin kushtet e përcaktuara në këtë dokument. Të drejtë për pjesëmarrje në "5 vjet Marigona Hill" kanë të gjithë personat fizikë mbi moshën 18 vjeç si dhe personat juridikë, të cilët i përmbushin kushtet e këtyre Rregullave, përveç punonjësve të Marigona Hill sh.p.k. dhe anëtarëve të familjes së ngushtë të tyre.

KLIENTËT DHE NJËSITË E KUALIFIKUARA PËR NDARJE TË SHPËRBLIMEVE

Për të fituar njërin nga dhuratat e kësaj fushate, të cilat do të ndahen në bazë të tërheqjes së rastësishme nga një komision treanëtarësh dhe në mënyrë publike në datën e përcaktuar këtu, klienti duhet të blejë një pronë të paluajtshme nga Marigona Hill sh.p.k., që mund të jetë shtëpi, tarracier, apartament apo lokal. Të drejtën e kualifikimit për shpërblime e fitojnë vetëm klientët që blejnë njësi ndërtimore drejtpërdrejt nga Marigona Hill sh.p.k. të cilët deri më datën 31 gusht 2024 i kanë paguar së paku vlerën prej 80.000.00€ për blerjen e tyre.

Në rast të anulimit të kontratave të shitblerjes të lidhura gjatë periudhës së këtij aktiviteti, Marigona Hill sh.p.k. ruan të drejtën e mbajtjes së shumës së vlerës së dhuratës së ndarë sipas këtyre Rregullave, krahas të drejtave tjera ligjore dhe kontraktuale.



FONDI I SHPËRBLIMEVE DHE NDARJA E TYRE

Të gjithë klientët që i përmbushin kriteret e përcaktuara me këto Rregulla do të shpërblehen nga Marigona Hill sh.p.k., në formë transparente dhe publike, përmes hedhjes së shorteut, i cili do të zhvillohet nga përfaqësues të Marigona Hill dhe blerësve të pranishëm, më datë 5 shtator 2024, pas kalimit të afatit të këtij aktiviteti.

Para tërheqjes së shorteut, do të publikohet lista e të gjithë klientëve të cilët kanë përmbushur kriterin e pjesëmarrjes në ndarjen e shpërblimeve, dhe të njëjtit do të kenë të alokuar numrin identifikues në bazë të numrit të kontratës së lidhur të shitblerjes me Marigona Hill sh.p.k. të shtypur në kuponë/tiketa.

Aktiviteti “5 vjet Marigona Hill” do të kulmojë me ndarjen e shpërblimeve për secilin klient që plotëson kushtet sipas këtyre Rregullave, të cilat ndahen në tri kategori:^a

i. **Shpërblimet e përgjithshme**, në të cilën kategori secili prej klientëve do të shpërblehet me nga një dhuratë nga Marigona Hill. Duke qenë se nuk është e mundur të parashikohet numri i klientëve me të drejtë të pjesëmarrjes në aktivitetin “5 vjet Marigona Hill”, organizatori zotohet që të gjithë klientët t’i shpërblejë sipas formulës së përcaktuar në këtë paragraf:

20% të klientëve do të shpërblehen me iPhone;

20% të klientëve do të shpërblehen me iPad;

20% të klientëve do të shpërblehen me Macbook;

20% të klientëve do të shpërblehen me AppleWatch; dhe

20% të klientëve do të shpërblehen me anëtarësi njëvjeçare në Una Spa & Fitness (e vlefshme për 2 persona x 2 anëtarësi) dhe me piktura nga artistë të shquar shqiptarë;

ii. **Shpërblimet e veçanta**, të cilat do t’i përfitojnë dy klientë me fat të cilët përzgjidhen përmes shorteut, në të cilin pjesë marrin të gjithë klientët, e që janë 1 kuponë me vlerë prej 5.000.00€ për blerje në dyqanin ekskluziv Solos Studio dhe një 1 “interior concept design” nga studio Archides, vlera e të cilës është 5,000 Euro; dhe

iii. **Shpërblimi i madh**, të cilin do ta fitojë klienti më me fat i cili përzgjidhet përmes shorteut, në të cilin pjesë marrin të gjithë klientët, e që është një veturë luksoze elektrike e prodhuesit Toyota, e tipit bZ4X 4x4, e re.



^a Shorteu do të tërhiqet në mënyrë transparente dhe publike sipas parimit: a. së pari tiketat e të gjithë klientëve të identifikuar sipas numrit të kontratës së shitblerjes me Marigona Hill do të vendosen në vazo dhe të gjithë do të marrin nga një dhuratë të klasifikuar si **shpërblimet e përgjithshme**; b. më pas, të gjitha tiketat e të gjithë klientëve të identifikuar sipas numrit të kontratës së shitblerjes me Marigona Hill do të vendosen sërish në vazo dhe dy nga ta do të tërhiqen nga vazo si fitues të **shpërblimeve të veçanta**; c. në fund, të gjitha tiketat e të gjithë klientëve të identifikuar sipas numrit të kontratës së shitblerjes me Marigona Hill do të vendosen sërish në vazo dhe njëri nga ta do të tërhiqet si fitues i **shpërblimit të madh**.



**MARIGONA
HILL**

Duke marrë pjesë në këtë aktivitet, klientët e Marigona Hill sh.p.k. konfirmojnë se janë plotësisht të njohur me dispozitat e këtyre rregullave dhe shprehimisht pajtohen me to.

Nënshkruar nga:

Në emër të organizatorit Marigona Hill sh.p.k.	
 Urgan Alja Drejtor i Përgjithshëm Marigona Hill Sh.P.K. 	Klienti: